



Nr. 438 Prot.

Tiranë, më 13 shtator 2023

NJOFTIM PËR PRANIMET
MASTER I SHKENCAVE NË EKONOMI DHE MENAXHIM
Viti Akademik 2023 -2024

Programi i studimit "Master i Shkencave" në "*Ekonomi dhe Menaxhim*" ka një kohëzgjatje dy vjeçare dhe zhvillohet në gjuhën italiane.

Kuotat dhe kriteret e pranimit

Për t'u pranuar ne Programin e Masterit të Shkencave në "*Ekonomi dhe Menaxhim*", kandidatët duhet të jenë të pajisur me një Diplomë të lëshuar nga një Universitet i Akredituar:

Për vitin akademik 2023 -2024, në programin e studimit Master i Shkencave në "*Ekonomi dhe Menaxhim*" do të vihen në dispozicion të kandidatëve gjithsej 41 kuota nga të cilat 25 për shtetas shqiptarë, 10 për shtetas të huaj (nga vendet BE dhe jo-BE) 5 për shtetasit e Kosovës dhe 1 për kandidatët shqiptarë me aftësi ndryshe.

Për t'u pranuar kandidatët duhet të kenë një nga kualifikimet e mëposhtme:

- A) Diplomë trevjeçare (Bachelor) në Shkenca Ekonomike ose Shkenca Politike të lëshuar nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë";
- B) Diplomë trevjeçare (Bachelor) në Ekonomi të lëshuar nga Universitetet italiane të njohura nga MIUR të Diplomave Trevjeçare të Kategorive L18 (Diplomë në Shkenca të Ekonomisë dhe Menaxhimit të Ndërmarrjeve) dhe L33 (Diplomë në Shkenca Ekonomike);
- C) Diplomë trevjeçare (Bachelor) në Ekonomi të lëshuar nga Universitetet e tjera shqiptare, nga Universitetet të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian apo vendeve të treta kundrejt Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, pas verifikimit të përputhshmërisë së kurrikulës së studimeve.

APLIKIMI

Për të aplikuar, kandidatët duhet të kryejnë procedurën e regjistrimit online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës 06 tetor 2023, ora 23:59, duke bashkëngjitur një kopje elektronike në formatin PDF të dokumentacionit vijues:

- a. Diploma universitare.
 - b. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara gjatë studimeve universitare të kryera më parë ;
 - c. Diploma e Maturës Shtetërore;
 - d. Lista e Notave/Certifikata e Diplomës së Maturës Shtetërore;
 - e. Kualifikime të tjera të vlerësueshme (kurse kualifikimi dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, Doktoratë);
 - f. Curriculum Vitae në gjuhën italiane;
 - g. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti).
- Pas ngarkimit të gjithë dokumentacionit të mësipërm, kandidatët e huaj duhet të paguajnë brenda datës 08 tetor 2023 tarifën prej 50 eurosh për aplikimin¹ si vijon

- Me transfertë bankare në llogarinë² me këto të dhëna:
Përfutuesi: Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
Banka: Intesa San Paolo Bank
BIC/Swift: USALALTR
IBAN: AL60208112040000030694935302
- me kartë krediti online në portalin e Universitetit : <https://admissions.unizkm.al/>;

¹ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

² Lutemi të dërgoni një kopje të faturës së pagesës së kuotës nëpërmjet tase.stud@unizkm.al

³ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e intervistës duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30 .

Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën.

Më pas do të kryhet kontrolli i dokumentave për secilin kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin e Universitetit.

Kandidatët që konsiderohen të kualifikuar pas verifikimit të dokumentacionit, duhet të paguajnë edhe tarifën për pjesëmarrjen në intervistën motivuese **brenda datës 13 tetor 2023, ora 16:30:**

- 2,000 lekë për shtetasit shqiptarë dhe shtetasit e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi;
- 100 euro për kandidatët e tjerë të huaj.

Pagesa do të kryhet me të njëjtat mënyra të përdorura për të paguar tarifën e aplikimit prej 50 Euro.

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja do të bazohet në vlerësimin e kualifikimeve. Rezultati përfundimtar do të jepet nga mbledhja e rezultateve të arritura (rezultati maksimal 100 pikë).

Kategoritë e kualifikimeve që do të vlerësohen me rezultatin maksimal që i atribuohet secilës prej tyre janë si më poshtë:

- A. Nota e Diplomës / Diploma deri në 40 pikë. Për studentët, nota e diplomimit do të llogaritet me mesataren e ponderuar të notave të të gjitha provimeve të dhëna në datën e fundit të këtij njoftimi;
- B. Diplomati e specializimit dhe kurset e thelluara, ato master, bazuar në kohëzgjatjen e programeve dhe rëndësinë e planit mësimor deri në 30 pikë;
- C. Përvoja profesionale e dokumentuar deri në 30 pikë.

Intervista motivuese në gjuhën italiane do të zhvillohet **në datën 14 Tetor 2023, ora 16:30**, në selinë e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Rezultatet e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/> **brenda datës brenda datës 18 tetor 2023.**

REGJISTRIMI

Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me prokurë noteriale, deri **në datën 27 Tetor 2023**, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Mandatin e kryerjes së pagesës së tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri "Tariffe");
2. Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës kopje të saj të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me kopje të diplomës të njehsuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
3. Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, të Udhëzimit nr.12 të datës 30/06/2023.
4. Kopjen e dokumentit të identifikimit;
5. Dy fotografi personale;
6. Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, vetëm për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile

Në rastet kur dokumentacioni i parashikuar në pikat 2 dhe 3 vjen nga një Universitet i huaj dhe nuk është në gjuhën shqipe apo italiane, ai duhet përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e parë e hyrjes në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të pasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor duhet të aplikojnë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Kandidatët të cilët do të kenë marrësi në dorëzimin e dokumentacionit të sipërpërmendur do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e Ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.
- Deklaratat sipas Shtojcave nr. 1 të Udhëzimit nr.12 të datës 30/06/2023.

Rektori
Prof. Leonardo Palombi

